



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:005476
Datë: 28.12.2023
Numri i dokumentit: 05139319

C-IV.-14-1832

Ankuesi

Z M, fshati S, P, përfaqësuar nga **Av. B I**, Prishtinë.

kundër

E paditura

N.SH “Kosovashpend” (në likuidim), e përfaqësuar nga
Agjencia Kosovare e Privatizimit, Rr. “Driton Hoxha”, nr. 55, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtari Shkelzen Sylaj, me 27 dhjetor 2023, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- I. Aprovohet pjesërisht si e bazuar ankesa e ankuesit dhe ndryshohet Vendimi i Agjencisë Kosovare të Privatizimit – Autoriteti i Likuidimit, PRN106-0028, i datës 25 shkurt 2014.**
- II. Obligohet AKP– Autoriteti i Likuidimit të N.SH-së në likuidim, që në emër të dëmshpërblimit për ndërprerjeje të parakohshme të kontratës së punës, t’ia paguaj ankuesit Z M, shumën prej 2,250 €, në emër të interesit ligjor prej 10 % të shumës themelore, t’i paguaj shumen prej 225 €, për hartimin e ankesës ti paguaj shumën prej 104 €, ndërsa pjesa tjetër e kërkesës përtej shumës së aprovuar, refuzohet si e pa bazuar.**
- III. Shumat e aprovuar si në pikën II të këtij dispozitivi do të përmbushen në pajtim të prioritetit sipas kategorisë së përcaktuar të kërkesave dhe interesave në procedurën e likuidimit.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 26 mars 2014, ankuesi dorëzoi në Dhomën e Posaçme, ankesë kundër Vendimit nr. PRN106-0028, të datës 25 shkurt 2014, të Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (më tej Autoriteti i Likuidimit ose shkurt AL), me të cilin ka kërkuar kompensimin për ndërprerje të parakohshme të marrëdhënies së punës në shumë prej 2,250 € (5 paga x 450 €), nga NSH “Kosovashped” (në likuidim). Ankuesi e kundërshton vendimin e AL duke shtuar se kërkesa e tij nuk është parashkruar ashtu siç ka konstatuar AKP në vendimin e saj. Thekson se parashkrimi është ndërprerë në kohën kur ankuesit i është lëshuara njoftimi për ndërprerje të marrëdhënies së punës. Prandaj një konstatim i tillë i AL është i pa bazuar. Ai pohoi se ishte punëtor i rregullt i ndërmarrjes deri në kohën kur Agjencia përmes njoftimit të dt. 30 gusht 2006 atij ia ndërpreu marrëdhënien e punës. Prandaj në bazë të llogaritjes së 5 pagave të tij mujore për 30 vjet përvojë të punës, ankuesi ka pohuar se i takojnë 2,250 € plus interes 10 %. I ka kërkuar edhe shpenzimet për përfaqësim. Ankuesi ka propozuar që, vendimi i AL të anulohet dhe të miratohet kërkesa e tij. Në mbështetje të ankesës ka dorëzuar në kopje: Autorizimit për përfaqësim, vendimin e kundërshtuar, njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës dhe librezën e punës.

Me 08 maj 2020, përfaqësuesi i ankuesit ka paraqitur një parashtresë për rregullimin e ankesës dhe ka kërkuar që Gjykata ta aprovoj shumën 3,150 € pra për 7 paga. I njëjti ka ripërsëritur qëndrimin e tij se kërkesa e tij nuk është parashkruar. Si provë për ta mbështetur pretendimin e tij sa i përket lartësisë së pagës mujore ai ka bashkangjitur një vendim të AL nr. PRN106-0029, të datës 25 shkurt 2014, e cila kishte të bënte për 3 paga të papaguara duke theksuar se AL nuk e kishte kontestuar shumën e lartësisë pagave, por ishte thirrur në parashkrim.

Me 26 shtator 2023, e paditura AKP-ja parashtrroi mbrojtje, në të cilën pohoi se AL ka bërë vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore janë zbatuar saktësisht. E paditura pohoi se ankuesi nuk ka treguar se cili nen i Ligjit 04/L-034 është shkelur nga AL në marrjen e vendimit. Po ashtu e paditura pohoi se kërkesa e ankuesit është e parashkruar në pajtim me nenin 36.2.1 të Shtojcës së Ligjit 04/L-034, dhe Nenit 608 të Ligjit për Punë të Bashkuar. Më tej e paditura pohoi se kërkesa duhet të jetë paraqitur para ndonjë gjykate apo organi tjetër kompetent brenda periudhës tre vjeçare nga momenti kur N.SH-ja supozohet të mos i ketë përmbushur obligimet e saj ndaj parashtruesit që rrjedhin nga marrëdhënia e punësimit. E paditura propozoi që ankesa të refuzohet si e pa bazuar dhe të vërtetohet vendimi i AL-së.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa aprovohet pjesërisht si e bazuar.

Në bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejshëm Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Gjykata ka shqyrtuar në tërësi të gjithë materialin e paraqitur në gjykatë nga të dyja palët dhe konstaton si në vijim.

Gjykata gjen se Agjencia Kosovare e Privatizimit – AL në rastin e vendosjes së kërkesës të ankuesit për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, pa ndonjë arsye këtë kërkesë e ka refuzuar si të pavlefshme dhe pa dhënë më këtë rast ndonjë arsyetim të bazuar. Arsyetimi i vendimit nga ana e AKP-së, se ankuesi është dashur kërkesën e tij ta parashtroj me kohë në gjykate apo tek organi kompetent dhe se e njëjta është parashkruar sepse në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar (Gazeta zyrtare nr.53 të vitit 1976) kjo është dashur të bëhet në afat prej 3 vite, nuk është i qartë dhe nuk përmban arsyet bindëse për refuzimin e kësaj kërkesë.

Me 27 dhjetor 2013, ankuesi kishte paraqitur kërkesën në AL për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, që është brenda afatit për paraqitjen e kërkesave tek AL. Gjykata konsideron si të drejtë procedurën e ndjekur nga ana e ankuesit kur i është drejtuar AL me kërkesën për dëmshpërblim.

Gjykata gjen si të pa bazuar dhe nuk e aprovon pretendimin e AKP-së të parashtruar në mbrojtje ndaj ankesës se kërkesa e ankuesit është e parashkruar. Thirrja në nenin 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar, sipas gjykatës nuk është i argumentuar, pasi që me këtë rast ky Ligj nuk mund të zbatohet për faktin se kjo çështje është e rregulluar me Ligjin mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si Ligj i posaçëm (lex specialis). Neni 40.1.6.2. i Shtojcës së Ligjit Nr.04/L-034 për AKP-në parasheh të drejtën në dëmshpërblim për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së punës të punëtorëve. Po ashtu me të njëjtin Ligj është paraparë që kërkesat e tilla punëtorët në pajtim me procedurat e Likuidimit i paraqesin tek AL kur N.SH hynë në likuidim. Këtë e ka bërë ankuesi, prandaj nuk ka pasur parashkrim të kërkesës meqë kemi të bëjmë me dëmshpërblim të cilin vet Ligji i AKP u njeh punëtorëve, prandaj thirrja e AKP-së në nenin 608 është e pa bazuar.

Ankuesi me njoftimin e datës 30 gusht 2006, ishte njoftuar se punësimi i tij përfundon me rastin e privatizimit të N.SH-së dhe se çdo kërkesë eventuale që mund të ketë ndaj N.SH-së, duhet ta parashtrojë me rastin e inicimit të procedurës së likuidimit. Futja e N.SH-së në procedurë të likuidimit në bazë të dispozitave ligjore ka qenë detyrë e të paditurës dhe nuk është varur nga vullneti i ankuesit, kështu ankuesi ka pasur pritje legjitime lidhur me fillimin e procedurës së likuidimit dhe parashtrimin të pretendimeve të tij kreditorë në po atë procedurë. Ankuesi me letrën e lartcekur është njoftuar se kërkesat kreditorë që mund ti ketë duhet ti parashtrojë kur të fillojë procedura e likuidimit dhe këtë e ka bërë ankuesi me kohë.

Nga njoftimi mbi Ndërprerjen e Marrëdhënies së Punës, vërtetohet fakti se ankuesi ishte në marrëdhënie pune në N.SH “Kosovashped” deri në kohën kur edhe u privatizua N.SH-ja. Pretendimi i të paditurës se kërkesa e ankuesit është parashkruar, nuk është i saktë. Gjykata vlerëson se parashkrimi është ndërprerë me njoftimin e datës 30 gusht 2006 dhe kështu

pretendimi i të paditurës, se kërkesa është parashkruar është jo i drejtë dhe nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore.

Baza ligjore për dëmshpërblim për shkak të ndërprerjes së punësimit ekziston në Neni 40.1.6.2. i shtojcës së Ligjit Nr.04/L-034 për AKP-në, i cili parasheh që punëtorëve u takon e drejta e dëmshpërblimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës nëse “ janë pushuar nga puna si rrjedhojë e Vendimit për Likuidim të ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga Agjencia sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP-në ”. Privatizimi është një ndër veprimet e AKP-së të parapara me nenin 6.2.1 të Ligjit për AKP-në, prandaj kërkesa për dëmshpërblim e ankuesit për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së punës është vlefshme dhe e bazuar.

E paditura as në vendimin e saj e as në mbrojtje në ankesë nuk e ka kontestuar ndërprerjen e marrëdhënies së punës dhe as lartësinë e pagesës për dëmshpërblim të ankuesit.

Neni 12.2 i Rregullores së UNMIK- ut 2001/ 27 (si ligj në fuqi në kohën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës) thotë që: “Në rastet e largimit të shkallës së gjerë nga puna zbatohen dispozitat e mëposhtme:

(dh) punonjësi nuk mund të largohet nga puna derisa punëdhënësi të mos ia ketë paguar atij një dëmshpërblim të njëkohshëm. Dëmshpërblimi duhet t'i paguhet punonjësit në datën e shkëputjes së kontratës së punës sipas shkallës së mëposhtme:

- (i) prej 2 deri në 4 vjet stazh 1 pagë mujore;*
- (ii) prej 5 deri në 9 vjet stazh 2 paga mujore;*
- (iii) prej 10 deri në 19 vjet stazh 3 paga mujore;*
- (iv) prej 20 deri në 29 vjet stazh 4 paga mujore;*
- (v) 30 vjet stazh e më tepër 5 paga mujore;*

Me rastin e aprovimit të shumës prej 2,500.00 €, Gjykata në bazë të Nenit 12.2 të Rregullores së UNMIK- ut 2001/27, për 30 vite të përvojës së punës në N.SH, ankuesit i takojnë 5 paga si dëmshpërblim për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së punës dhe meqenëse e paditura në përgjigjen në ankesë nuk e ka kontestuar as stazhin e punës dhe as lartësinë e pagës prej 450.00 €, ankuesit i takon dëmshpërblimi në lartësi të përgjithshme prej 2,250.00 € (5 paga x 450 €), e jo siç pretendon ankuesi me rregullimin e ankesë 7 paga. Prandaj kërkesa e ankuesit përtej shumës së aprovuar është pabazuar.

Nga kjo gjendje faktike e vërtetuar, gjykata vie në përfundim se ankuesi Z M ishte punëtorë i NSH-së në kohën e privatizimit të saj dhe se i takon e drejta në dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, në shumën e aprovuar.

Gjykata e aprovon shumën në lartësi prej 250 €, në emër të interesit ligjor bazuar në nenin 37.3 të shtojcës së Ligjit nr. 04 / L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Sipas nenit të lartcekur të gjitha kërkesat e bëra ndaj Ndërmarrjes mund të përfshijnë kamatë në çfarëdo shume themelore të grumbulluar deri para datës së Vendimit të Likuidimit, me kusht që kjo kamatë të mos tejkalohet 10% (dhjetë për qind) të shumës themelore.

Në bazë të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Shpenzimet gjyqësore

Në bazë të nenit 62.2 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, e paditura AKP si palë e pasuksesshme, obligohet ti paguaj shpenzimet e procedurës.

E paditura është obliguar ti paguaj ankuesit shpenzimet e procedurës në bazë të rregullores së tarifës së Odës së Avokatëve dhe atë për hartimin e ankesës shumen prej 104.00 €.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Shkelzen Sylaj, Gjyqtar